Dynjaja është një pasuri (kënaqësi) e përkohshme, ndërsa kënaqësia më e mirë e dynjasë është gruaja e devotshme.”

Abdullah ibën Amri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Dynjaja është një pasuri (kënaqësi) e përkohshme, ndërsa kënaqësia më e mirë e dynjasë është gruaja e devotshme.”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti në këtë hadith na tregon se dynjaja dhe ajo që gjendet në të është diçka që përmes saj arrihet kënaqësi për një kohë dhe pastaj kalon, por kënaqësia më e mirë e saj është gruaja e devotshme, të cilën, kur e shikon, e gëzon; kur e urdhëron, i bindet, e, kur nuk është i pranishëm, e ruan nderin dhe pasurinë e tij.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5794